



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

K.DH.SH.II.nr.958/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Dhoma e Shkalles se Dytë, me gjyqtar Faton Bajrami, në çështjen përmbareme të kreditorit ë kreditorit N.P "Kosova Projekt & Construction", me NRB: 70876019, me seli në Prishtinë, ndaj debitorit Kisha Pentakostane e Krishtit (Bashkësia e Popullit të Zotit), me numër të regjistrimit 94003679, me seli në Prishtinë, me bazë juridike përmbareme, duke vendosur lidhur me ankesën e debitorëve, të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale te Kosovës - Departamenti për Çështje Ekonomike KPPP.nr.1915/22, të datës 03.03.2023, me datë 06.09.2023, mori këtë:

A K T V E N D I M

HUDHET ankesa e debitorit Kisha Pentakostane e Krishtit (Bashkësia e Popullit të Zotit), me numër të regjistrimit 94003679, me seli në Prishtinë e paraqitur kundër Aktvendimit të Gjykatës Komerciale te Kosovës - Departamenti për Çështje Ekonomike KPPP.nr.1915/22, të datës 03.03.2023, **si e pasfatshme**.

A r s y e t i m

Gjykata Komerciale e Kosovës - Departamenti për Çështje Ekonomike, me aktvendimin e atakuar KPPP.nr.1915/22, të datës 03.03.2023, e ka refuzuar si te pabazuar ankesën e debitorit debitorit Kisha Pentakostane e Krishtit (Bashkësia e Popullit të Zotit), me të cilën ka kërkuar që të aprovohet ankesa e debitorit lidhur me parregullsitë me rastin e kryerjes së përmbaremit dhe të anulohet konkluzioni sipas lëndës përmbareme P.nr.801/17 dt. 27.11.2017, i lejuar të Përmbareuesit Privat Destan Bujupaj me datën 16.11.2021 si kundërligjor.

Kundër këtij aktvendimi, ka ushtruar ankesë debitori (*me pretendime si në ankesë*), me propozim gjykatës së shkallës së dytë që të aprovohet si e bazuar ankesa dhe të ndryshohet aktvendimi i atakuar, ashtu që të anulohet e tere procedura përmbareme, e udhëhequr kundër debitorit, me pretendimin se kreditori nuk ka asnjë baze qe te kërkoj kredinë, si ne propozim.

Përgjigje në ankesë nuk ka ushtruar kreditori.

Dhoma e Shkalles se Dytë e Gjykatës Komerciale, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3, paragrafi 2 dhe nenit 79 të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbartimore si dhe në kuptim të nenit 194 dhe 208 të LPK-së, gjeti se:

- Ankesa e debitorit është e pasafatshme.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori N.P "Kosova Projekt & Construction", me NRB: 70876019, me seli në Prishtinë, me datën 24.11.2017, ka paraqitur propozim për përmbartim ndaj debitorit Kisha Pentakostane e Krishtit (Bashkësia e Popullit të Zotit), me numër të regjistrimit 94003679, me seli në Prishtinë, në bazë të dokumentit te besueshëm – faturës nr.08/2017 te datës 07.11.2017, për shumën e detyrimit në vlerë totale prej 1,300 euro.

Ndaj urdhrit për përmbartim debitorët kanë ushtruar prapësim duke arsyetuar se kemi të bëjmë me shkelje të dispozitave procedurale dhe vërtetim të gabuar të gjendjes faktike, duke propozuar qe prapësimi të aprovohet kurse Urdhëri Përmbartimor të anulohet.

Gjykata Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm pas vlerësimit te prapësimit dhe përgjigjes ne prapësim, ka refuzuar prapësimin e debitorit Kisha Pentakostane e Krishtit (Bashkësia e Popullit të Zotit), me numër të regjistrimit 94003679, me seli në Prishtinë, si te pabazuar dhe ka lënë në fuqi urdhrin për përmbartim. Në arsyetim të aktvendimit të atakuar gjykata ka theksuar se debitori prapësimit nuk i ka bashkangjitur provat për të argumentuar pretendimet e veta në të cilat thirret në prapësim apo se ekzistojnë ndonjëra nga shkaqet e parapara sipas dispozitës së nenit 71 të LPP –së.

Debitori me datë 30.11.2021, pranë përmbartuesit privat Destan Bujupaj ka paraqitur ankesë lidhur me parregullsitë e përmbartuesit privat gjatë kryerjes së përmbartimit sipas urdhrit përmbartimor P.nr. 801/17 të datës 27.11.2017, për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës përmbartimore dhe asaj detyrimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe shkeljes së ligjit përmbartimor. Në ankesë ndër të tjera, ka deklaruar se nga ana e zyrës përmbartimore nuk janë ndërmarr veprimet përkatëse të domosdoshme ligjore që kanë të bëjnë me procedurën përmbartimore, pasi që debitori me kohë dhe në afatin e paraparë ligjor ka parashtruar ankesë ndaj aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, PPP.nr. 1003/20 të datës 21.07.2021, me të cilin ishte refuzuar si i pa bazuar prapësimi i debitorit, i lejuar nga ana e Përmbartuesit Privat kjo nga shkak sepse nga ana e Gjykatës Themelore ne Prishtinë, ishte lejuar anesa në afat prej 7 ditësh nëpërmes kësaj gjykate për gjykatën e Apelit në Prishtine, duke shtuar se lënda në fjalë është akoma në procedurë ankimore pranë gjykatës së shkallës së dytë, dhe lidhur me të akoma nuk është marr vendim nga ana e kësaj gjykate, prandaj në vështrim të nenit 74 të LPP-së, vendimi lidhur me konkluzionin e datës 16.11.2021 sipas urdhrit përmbartimor P.nr.801/17 të datës 27.11.2017, nuk është i formës së prerë dhe si i tillë nuk mund të përmbartohet. Andaj, ka

pretenduar se duke marrë parasysh pretendimet e sipërshënuara, si debitor ka konsideruar se për shkak të parregullsive të procedurës përmbarimore, në asnjë mënyrë nuk mund të bëhet ekzekutimi i aktvendimit përmbarimore dhe konkluzionit të marr nga zyra përmbarimore për shkak të mosarritjes së formës së prerë dhe përmbarueshmërisë në procedurën e përmbarimit, prandaj i propozoj gjykatës që të aprovohet ankesa e debitorit lidhur me parregullsitë me rastin e kryerjes së përmbarimit dhe të anulohet konkluzioni sipas lëndës përmbarimore P.nr.801/17 të datës 27.11.2017, i lejuar të Përmbaruesit Privat Destan Bujupaj me datë 16.11.2021 si kundërligjor, andaj si i tillë i njëjti të hedhet poshtë si i pa lejuar

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar lidhur me ankesën-kërkesën për parregullsi të paraqitur nga ana e palës debitore me aktvendimin e atakuar KPPP.nr.1915/22, të datës 03.03.2023, e ka refuzuar si të pabazuar ankesën-kërkesën e palës debitore, duke vendosur më decidivishtë si në dispozitiv të aktvendimit të atakuar.

Dhoma e Shkalles se Dytë, e Gjykatës Komerciale, me shikimin në fletë kthesën për dorëzim vërtetoi se pala debitorë, aktvendimin e atakuar KPPP.nr.1915/22, të datës 03.03.2023, e ka pranuar me datë 27.03.2023. Ankesa ndaj këtij aktvendimi është pranuar në gjykatë me datën 05.04.2023 që vërtetohet nga data e vendosur në ankesë në vulën e pranimi të gjykatës.

Pasi që afati për ankesë, sipas dispozitës së nenit 509, pika c), të LPK-së dhe nenit 77 dhe 79 të Ligjit për Procedurën Përmbarimore është 7 ditë nga dita e pranimi të aktvendimit . Nga kjo rezulton që ankesa është dorëzuar pas skadimit të afatit ligjor prej 7 ditësh, për faktin se afati fillon të llogaritet nga data 28.03.2023 dhe kur llogariten 7 ditë, atëherë dita e fundit për parashtrimin e ankesës ka qenë data 03.04.2023. Me që pala debitorë, ankesën e ka paraqitur me datë 05.04.2023, rezulton se ankesa është paraqitur me vonesë prej 2 dite.

Në bazë të nenit 186.1 të LPK-së, parashihet se ankesa e paraqitur pas afatit të parashikuar me ligj, ankesën jo të plotë, apo ankesën e palejueshme e hedh poshtë me aktvendim gjykata e shkallës së parë pa caktuar fare seancë gjyqësore. Ndërsa në bazë të nenit 186.2 të LPK-së, parashihet se ankesa është e pasafatshme po që se është paraqitur pas skadimit të afatit ligjor. Pasi që gjykata e shkallës së parë nuk e ka hedh poshtë si të pasafatshme ankesën e palës, gjykata e shkallës së dytë në bazë të nenit 196 të LPK-së, e ka hedhë poshtë ankesën si të pasafatshme, për shkak se këtë veprim nuk e ka kryer gjykata e shkallës së parë.

Kompetenca e Dhomës se Shkalles se Dytë për të vendosur nga ana e gjyqtarit individual bazohet në dispozitivin e nenit 3 paragrafi 2 të LPP-së, me të cilën është paraparë se në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual.

Nga të cekurat u vendos sikurse në vendim në bazë të nenit 195.1 nën pikën a) e lidhur me nenin 196, të LPK-së

**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS,
Dhoma e Shkalles se Dytë
K.DH.SH.II nr.958/23, me datë 06.09.2023**

**Gjyqtar
Faton Bajrami**